

DY KONFERENCA TË ALBANOLOGES KINEZE PROF. KE JIN

Më 22 janar 2018 në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë albanologia kineze, prof. Ke Jin nga katedra e gjuhës shqipe në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit (Beijing Foreign Studies University BFSU), mbajti një ligjëratë për krijimtarinë e gjenit të letrave shqipe, Ismail Kadare. Njoftimi për këtë veprimtari u prit me interesim të veçantë, prandaj në sallën “Aleks Buda” ishin të pranishëm studiues të shumtë të gjuhës dhe të letërsisë shqipe, të shkencave të tjera shoqërore dhe të natyrës, shkrimtarë dhe artistë; gazetarë të televizioneve dhe të gazetave të ndryshme; punonjës të institucioneve kulturore, diplomatë shqiptarë e kinezë etj.

Veprimtarinë e çeli sekretarja e Akademisë së Shkencave, akad. Floresha Dado, e cila vlerësoi veprimtarinë e Departamentit të Gjuhës Shqipe në Universitetin e Pekinit. Në këtë universitet kanë mësuar dhe vijnë të mësojnë gjuhën shqipe një numër i konsiderueshëm studentësh kinezë që nga viti 1961, kur u hap ai departament. Shumë prej tyre kanë ardhur për të plotësuar studimet për gjuhën shqipe në Universitetin e Tiranës, që prej më se 50 vjetësh. Prof. Ke Jing vuri në dukje përkthimet e shumta nga letërsia shqipe në gjuhën kineze, sidomos vepra të I. Kadaresë dhe D. Agollit.

F. Dado foli edhe për veprimtarinë e albanologes Ke Jin, që nga arsimimi i lartë i saj në Universitetin e Prishtinës për gjuhën e letërsinë shqipe (1985-1989) dhe krijimtarinë e saj rreth gjuhës shqipe deri në ditët e sotme, duke përmendur sidomos ndihmesën e albanologes Ke Jin për ta bërë më të njohur në Kinë letërsinë

e re shqiptare, karakteristikat, temat, gjinitë dhe zhvillimin e saj. Prof. Ke Jin ka mbrojtur doktoratën në Universitetin e Luisvilit (Louisville – SHBA) me temën “The Four “Others” in I. Kadare’s Works - A Study of the Albanian National Identity” (“Katër “Të tjerët” në veprat e I. Kadaresë – një studim për identitetin kombëtar shqiptar”).

Albanologia Ke Jin në fjalën e saj në gjuhën shqipe e tërhoqi auditorin me njohuritë e saj rreth kulturës dhe krijimtarisë letrare në Shqipëri dhe vlerësimet origjinale që shprehu. Ajo vlerësoi emancipimin e shoqërisë shqiptare edhe nëpërmjet krijimtarisë letrare të I. Kadaresë, D. Agollit, F. Arapit, Xh. Spahiut, J. Xoxës e të shumë krijuesve të tjerë. Lektorja nënvizoi se krijimtaria letrare shqipe, sidomos ajo e I. Kadaresë, është bërë gjerësisht e njohur në Kinë. Përkthimet janë bërë kryesisht nga gjuha franceze; por edhe nga gjuha ruse, angleze etj. Prof. Zheng Enbo ka përkthyer drejtpërdrejt nga shqipja në gjuhën kineze, por edhe përkthyes të tjerë.

Lektorja iu përgjigj pyetjeve të shumta rreth ndikimit të letërsisë shqipe në letërsinë kineze, rreth vendit që zë letërsia jonë në shijet e lexuesit kinez; rreth gjykimeve të saj për veçantitë e krijimtarisë së I. Kadaresë, D. Agollit etj.

Në bibliotekën e Këshillit të Ministrave, në datën 20 shkurt 2018 albanologia Ke Jin mbajti një ligjëratë për veprimtarinë e Departamentit të Gjuhës Shqipe në Universitetin e Pekinit. Veprimtaria u mundësua në

bashkëveprim me qendrën COD dhe me Shoqatën e Gjuhësisë Shqiptare.

Ishin të pranishëm studiues të gjuhës, të letërsisë dhe të shkencave të tjera shoqërore dhe të shkencave natyrore; shkrimtarë, përkthyes, pedagogë të universiteteve të ndryshme, gazetarë, diplomatë dhe studentë. Morën pjesë edhe përfaqësues të ambasadës kineze në Tiranë dhe studentë kinezë që studiojnë në Universitetin e Tiranës.

Veprimtarinë e çeli prof. dr. Emil Lafe, kryetar i Shoqatës së Gjuhësisë Shqiptare. Profesori përhëndeti të pranishmit dhe theksoi frytet e veprimtarisë shkencore e mësimore të albanologes Ke Jin dhe të Departamentit të Gjuhës Shqipe në Universitetin e Pekinit. Ai përmendi një varg veprash të letërsisë shqipe të përkthyer në gjuhën kineze, theksoi numrin relativisht të madh të studentëve kinezë që kanë studiuar në Tiranë që me themelimin e Universitetit të Tiranës dhe të studentëve shqiptarë që kanë studiuar në Kinë. Prof. E. Lafe përmendi rirforcimin e marrëdhënieve kulturore, shkencore dhe ekonomike shqiptaro-kineze gjatë 30 vjetëve të fundit.

Prof. Ke Jin paraqiti në monitor veprimtarinë e Departamentit të Gjuhës Shqipe në Universitetin e Pekinit, duke periodizuar edhe numrin e saktë të studentëve kinezë që kanë përfunduar studimet për gjuhën shqipe vit pas viti. Ajo vuri në dukje se gati të gjithë studentët kinezë janë punësuar si përkthyes, studiues, pedagogë, diplomatë, gazetarë etj. Deri tanë në Universitetin e Gjuhëve të Huaja të Pekinit janë hapur 83 degë studimore gjuhësh të huaja. Deri në

vitin 2020, sipas saj, do të studiohen 103 gjuhë të huaja; pra gjithë gjuhët e vendeve me të cilat Kina ka marrëdhënie diplomatike.

Në Universitetin e Pekinit, të Shangait, Tian Qinit etj. kanë përfunduar studimet një numër i madh specialistësh shqiptarë, por edhe specialistë për gjuhën kineze. Specialistët e shumtë kanë shërbyer në kombine dhe uzina të ndryshme të ndërtuara në Shqipëri me ndihmën dhe bashkëpunimin e Kinës. Veprimtari të tilla kanë hedhur themelet e miqësisë ndërmjet dy popujve.

Prof. Ke Jing paraqiti një panoramë të plotë veprave të letërsisë shqipe të përkthyer në gjuhën kineze. Natyrisht, kryet e vendit e zë krijimtaria e I. Kadaresë, më pas vjen krijimtaria e D. Agollit dhe e një vargu poetësh e prozatorësh të tjerë. Studiuesja theksoi se po punohet që përkthimet në gjuhën kineze të bëhen drejtpërdrejt nga gjuha shqipe, sepse te përkthimet nga gjuhë të tjera, sado të përkryera, mund të ndodhin zhvendosje a bjerrje kuptimesh.

Studiues, shkrimtarë, pedagogë, gazetarë etj. i bënë pyetje të shumta; të cilave prof. Ke Jing iu përgjigj me durim e saktësi. Disa prej tyre vlerësuan rolin e Departamentit të Gjuhës Shqipe në Universitetin e Pekinit dhe ndihmesën e albanologes Ke Jin për të bërë të mundur që të njihet më gjerë e më mirë letërsia dhe kultura shqiptare në Kinë e gjetkë.

Albanologia përhëndeti të pranishmit, shkëmbeu materiale studimore me ta dhe premtoi se do ta thellojë veprimtarinë kulturore-shkencore për gjuhën dhe kulturën shqiptare.

KUJTIM KAPLLANI